



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/33

Datë: 26.08.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, Ligjit Nr. 08/L-159 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kompakt të Sfidave të Mijëvjeçarit dhe Marrëveshjes për zbatimin e Programit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Marrëveshja Kompakt), përfaqësuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), si dhe me Letrën e Zbatimit të MCC-së, të datës 25 shtator 2024, mbi përshtatshmërinë, përzgjedhjen dhe kompensimin e drejtorëve të Bordit të entitetit shumëfunksional për ruajtje të energjisë (MFES)/Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata e Ruajtjes së Energjisë", në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lartësia e kompensimit mujor të anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata e Ruajtjes së Energjisë" - KRE (Energy Storage Corporation - EScorp) SH.A. sipas shtojcës së këtij Vendimi.
2. Lartësia e kompensimit e caktuar me pikën 1. vlen për periudhën e zbatimit të Marrëveshjes Kompakt. Gjatë kësaj periudhe, kompensimi mbulohet nga Llogaria e Sfidave të Mijëvjeçarit - Kosovë.
3. Pas periudhës së zbatimit të Marrëveshjes Kompakt, kompensimi mbulohet nga vetë ndërmarrja, sipas lartësisë së caktuar me vendim të Qeverisë.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë ta zbatojë këtë Vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca: Tabelat e nivelit të kompensimit për drejtorët e Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Korporata e Ruajtjes së Energjisë”.

Tabela 1: Niveli i kompensimit të Drejtorëve të Bordit:

Pozita	Niveli i kompensimit
Kryesues	3,616€
Anëtar	3,150€



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/33
Datë: 26.08.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dhënia në shfrytëzim e hapësirës, Parcelës Kadastrale P-9012-0 me sipërfaqe prej 999 m², të cilat janë në pronësi të Agjencisë Pyjore të Kosovës - Ndërmarrja e Pyjeve në Prizren, për nevoja të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Dhënia në Shfrytëzim e kësaj prone Ministrisë së Drejtësisë do të kontribuojë në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore për realizimin e nevojave institucionale të kësaj Ministrice, në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në racionalizimin e kostove operative.
3. Parcelat e identifikuar janë verifikuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe është konstatuar se janë të përshtatshme për t'ia dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Drejtësisë.
4. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/33

Datë: 26.08.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, të nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës, për transfer të mjeteve, në shumë prej 4,333,900€ (katër milionë e treqind e tridhjetetë mijë e nëntëqind euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht, për furnizim me barna nga Lista e Barnave Esenciale.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës, me kod 220, nga kategoritë e shpenzimeve dhe nënprogramet, si në vijim:
 - 2.1. Nga nënprogrami Administrata Qendrore e SHSKUK-së, me kod 11320, nga kategoria e shpenzimeve "Investimet kapitale", konkretisht nga projekti "Blerja e Pajisjes Mjekësore për Njësitë Përbërëse të SHSKUK-së", me kod 18235, shuma prej 2,416,600€ (dy milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind eurosh), transferimi është -25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nënprogramit (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nënprogram gjatë vitit 2026);
 - 2.2. Nga nënprogrami Shërbimet Terciare Shëndetësore - QKUK, me kod 70100, nga kategoria e shpenzimeve "Investimet kapitale", merret shuma prej 1,917,300€ (një milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind eurosh), transferi është -25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nënprogramit (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nënprogram gjatë vitit 2026), mjetet merren nga këto projekte:
 - Ndërtimi i Depos së Barnatores Qendrore, QKUK, me kod 19312, shuma prej 400,000€ (katërqind mijë eurosh);
 - Pajisje Mjekësore për nevoja të Programeve Buxhetore të SHSKUK-së, me kod 15707, shuma prej 1,100,000€ (një milion e njëqind mijë eurosh) dhe
 - Ndërtimi i objektit për Klinikën Hemato-onkologjike, me kod 15710, shuma prej 417,300€ (katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind eurosh).

3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi transferohen në Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës, me kod 220, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si në vijim:
 - 3.1. Në nënprogramin "Administrata Qendrore" e SHSKUK-së, me kod 11320, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma prej 2,833,900€ (dy milionë e tetëqind e tridhjetetrec mijë e nëntëqind eurosh).
 - 3.2. Në nënprogramin "QKUK - Shërbimi Terciar Shëndetësor", me kod 70100, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma prej 1,500,000€ (një milion e pesëqind mijë eurosh).
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/33

Datë: 26.08.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për transferim të mjeteve në shumë prej 1,000,000.00€ (një milion eurosh) deri nën 20.68% të ndarjes së ndikuar negativisht, për mbulimin e obligimeve që kanë të bëjnë me shpenzime operative.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Punëve të Brendshme, me kod 214, nga kategoritë e shpenzimeve dhe nënprogrami, si në vijim:
 - 2.1. Nga nënprogrami "Shërbimet e Administratës Qendrore", me kod 11314, nga kategoria e shpenzimeve "Investimet kapitale", konkretisht nga Projekti "Blinaja", me kod 15057, shuma prej 1,000,000.00€ (një milion eurosh), transferimi është -20.68% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nënprogramit.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi transferohen në programin "Policia e Kosovës", në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si në vijim:
 - 3.1. Në nënprogramin "Shërbimet Administrative", me kod 30000, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transference", shuma prej 450,000€ (katërqind e pesëdhjetë mijë eurosh).
 - 3.2. Në nënprogrami "Shërbimet e Mbështetjes", me kod 30400, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", shuma prej 150.000€ (njëqind e pesëdhjetë mijë eurosh) dhe në kategorinë e shpenzimeve komunale, shuma prej 400,000€ (katërqind mijë eurosh).
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/33
Datë: 26.08.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komunës së Podujevës për transferimin e mjeteve, në shumën prej 300,000.00€ (treqind mijë eurosh), që përbën deri në 18.18% të ndarjes së ndikuar negativisht, për mbulimin e obligimeve kontraktuale.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Komuna e Podujevës, me kod 615, nga kategoria e shpenzimeve dhe nënprogrami, si në vijim:
 - 2.1 Nga nënprogrami "Arsimi fillor", me kod 93120, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", nga projektet si vijon:
"Tabela digjitale mësimore", me kod 52635, shuma prej 100,000.00€ (njëqind mijë eurosh);
"Ndërtimi i aneksit të shkollës "Xheladin Rekaliu", me kod 55899, shuma prej 200,000.00€ (dyqind mijë eurosh).
3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi transferohen në nënprogramin dhe kategorinë e shpenzimeve si në vijim:
 - 3.1 Në nënprogramin "Arsimi i mesëm i lartë", me kod 94320, në kategorinë e shpenzimeve "Investime kapitale", në projektin "Ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme", me kod 51920, shuma prej 300,000.00€ (treqind mijë eurosh).
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Komuna Podujevës, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/33
Datë: 26.08.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 2. të Ligjit Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, nenit 11 të Statutit të këshillit Konsultativ për Komunitete, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i nominon tre (3) përfaqësues të saj në Këshillin Konsultativ për Komunitete si në vijim:
 - 1.1. Flora Macula, Shefe e Stafit të Kryeministrit;
 - 1.2. Gyltene Osmani - Ilazi, Këshilltare Politike e Kryeministrit;
 - 1.3. Igor Rašić, Shefi i Kabinetit të Ministrit për Komunitete dhe Kthim.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedoj Këshillit Konsultativ për Komunitete i cili vepron nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë